



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-553/01-0034734-2/76 dt. 25.06.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 9 dhe 18 të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve dhe pas shqyrtimit të Propozim-Vendimit Nr. 01-553/01-0034734/26, dt. 16.06.2026, të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), të nxjerrë në bazë të Raport-Rekomandimit Nr. 17-553/01-0034689/26, dt. 16.06.2026, të Komisionit të ZKKK-së për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë me pako ushqimore dhe higjienike, Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** Propozim-Vendimi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim Nr. 01-553/01-0034734/26, dt. 16.06.2026, dhe i lejohet shfrytëzimi i mjeteve financiare nga buxheti i Komunës së Mitrovicës së Jugut në shumë totale prej 4,126.60 € (katër mijë e njëqind e njëzetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë cent) si ndihmë-përkrahje financiare për blerjen e pakove ushqimore dhe higjienike për 94 (nëntëdhjetë e katër) familje me gjendje të rënd ekonomiko-sociale nga radhët e komunitetit-ve pakicë, në vlerë për 1 (një) pako prej 43.90 € (dyzet e tre euro e nëntëdhjetë cent) për secilën familje, si në Raport- Rekomandimin e Komisionit të ZKKK-së Nr. 17-553/01-0034689/26, dt. 16.06.2026.
2. Mjetet e lejuara sipas pikës 1 të këtij vendimi do të barten-paguhën në xhirollogarinë bankare të N.T.SH. "Genci" (xhirollogaria bankare Nr. 1305001001644633 – BPB Banka), ku do të bëhet blerja e pakove ushqimore dhe higjienike sipas Kontratës së Prokurimit "Furnizim me Pako Ushqimore dhe Higjienike për familje – Raste Sociale në Mitrovicë", me Nr. të prokurimit 642-23-618-1-1-1 dhe Nr. të brendshëm, 642/23/005/111, me Nr.prot. 01-370/03-0058736/23, dt. 07.08.2023, ndërkaq pagesa do të realizohet pas pranimit të tyre nga këto familje, konkretisht, të dorëzimit të regjistrit të familjeve përfituese si në Raport-Rekomandimin e Komisionit të lartcekur.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, ndërsa mjetet e parapara



sipas këtij Vendimi paguhen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe Transfere të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Shtojcë:

- 1x1 Propozim-Vendimi i ZKKK-së, Nr. 01-553/01-0034734/26, dt. 16.06.2026;
- 1x1 Raport-Rekomandimi i Komisionit të ZKKK-së Nr. 17-553/01-0034689/26, dt. 16.06.2026.

T'i dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- 1x1 Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- 1x1 Arkivit

